



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2256/2 prot.,

Datë 18.09.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Be-Is” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77189-08-10-2023, me objekt: “*Loti I “Rehabilitimi i ambienteve tek komplekski “Fushat Sportive Tirana” me fond limit 28,023,943 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Sportive Tirana.*”

**Ankimues:** “Be-Is” SHPK, me NUIS K71412003A, me adresw: “*Rr. “Qemal Stafa”, Pallati nr.66, Shk.3, Ap.24, Tiranë*”

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Sportive Tirana me adresw: Rruga: “*Kristo Luarasi*” Tiranë

Në datën 15.09.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2256 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3416 e operatorit ekonomik “Be-Is” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77189-08-10-2023, me objekt: “*Loti I “Rehabilitimi i ambienteve tek komplekski “Fushat Sportive Tirana” me fond limit 28,023,943 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Sportive Tirana.*”

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Be-Is” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*”

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Be-Is” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2256 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

*“Oferta e paraqitur nga operatori BE-IS sh.p.k. skualifikohet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjitha kriterëve te kerkuara ne DST, konkretisht nuk ka plotesuar kriteret sipas: 2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik: O.E. nuk ka paraqitur listepagesat per periudhen Maj -Korrik 2023, gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues per drejtuesit Teknik te kerkuar, ku perfshihen “Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv”. O.E. gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues per punonjës të specializuar/të kualifikuar te kerkuar, ku perfshihen • kontratën individuale të punës; • një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional /certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. 2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës: O.E. nuk ka paraqitur dokumentacionin për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet : a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor); b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit); f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij. Kur janë me qera, duhet të paraqitet : a) kontrata e qerasë; b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit); f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij..”*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 18.09.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**